

POLITIKA E CILËSISË

ASSECO SEE KOSOVË është e përkushtuar që të ofrojë shkallën më të lartë të shërbimeve cilësore në industrinë e teknologjisë së informacionit, në kohë të duhur dhe në vazhdimësi, për përmbushjen e kërkesave të klientëve duke rezultuar në kënaqësinë e tyre. Për të arritur këtë zotim, ne ofrojmë shërbime dhe produkte që përmbushin pritshmëritë e klientëve dhe sigurojmë cilësinë optimale në mënyrë të vazhdueshme.

ASSECO SEE KOSOVË:

- Siguron që kërkesat dhe pritshmëritë e klientit janë përmbushur,
- Krijon kushtet optimale të punës për të gjithë stafin, dhe
- Përmirësonë në mënyrë të vazhdueshme proceset për ofrimin e shërbimeve cilësore për klientë.

Top-Menaxhmenti i ASSECO SEE KOSOVË, me qëllim të arritjes së objektivave strategjike ka ngritur Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë të bazuar në standardin ndërkombëtar ISO 9001:2015. Sistemi i cilësisë është ndërtuar në parimet e përmbushjes së kënaqësive të klientëve, përkushtimit të menaxhmentit dhe përmirësimit të vazhdueshëm në mënyrë që të sigurojmë arritjen e objektivave të cilësisë, të vendosura në ASSECO SEE KOSOVË.

Objektivat kuantitative të cilësisë janë të vendosur duke u bazuar në karakteristikat e matshme për të siguruar integritetin e sistemit tonë dhe janë të monitoruara dhe rishikuara nga menaxherët të cilët mbahen përgjegjës për rezultatet e tyre. Në mënyrë të vazhdueshme sigurohemi që objektivat tona të

cilësisë të janë efikase dhe të realizohen sipas kërkesave të parapara.

ASSECO SEE KOSOVË, është plotësish i zotuar që në vijimësi të përmirësoj efikasitetin e sistemit të cilësisë përmes mekanizmave monitorues dhe matës.

Ky zotim plotësohet përmes mekanizmave të mëposhtëm:

- Rishikimet e menaxhimit,
- Auditimet e brendshme,
- Trajnimet,
- Një programi veprues dhe korrigjues që përfshinë ekipe shumë-funksionale për analizimin e shkaqeve dhe zgjidhjen e problemeve të mundshme,
- Aplikimit të çasjes në proces dhe të menduarit të bazuar në rrezik, dhe
- Rishikimet e çështjeve të brendshme dhe jashtme, si dhe kërkesave të palëve relevante të interesit.

Secili punonjës është i vetëdijshëm për vizionin, misionin, strategjinë dhe objektivat e ASSECO SEE KOSOVË dhe i vendosur për arritjen e kërkesave të klientëve.

Punonjësit e ASSECO SEE KOSOVË janë të motivuar dhe të trajnuar me kujdes mbi metodat e menaxhimit të cilësisë, të pajisur me procedurat dhe udhëzimet e punës dhe të furnizuar me mjetet dhe resurset e duhura për të përmbushur cilësinë e kërkuar në fushën e tyre të veprimit.

Top-Menaxhmenti angazhohet të aktivizojë dhe të mbështesë këtë Politikë të Cilësisë dhe objektivat e cilësisë duke i verifikuar vazhdimisht, sidomos përmes rishikimeve të menaxhmentit.

Në ASSECO SEE KOSOVË, objektivat e cilësisë dhe ato të biznesit janë në një linjë

Valon Budima
CEO
ASSECO SEE KOSOVË

